

V E N D I M
Nr. 704, datë 21.12.2000

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.129, DATË 18.3.1999, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E
LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.4, DATË 12.1.2000, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 dhe 21, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në Kreun IV të vendimit nr.129, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet për pajisjen me leje tregtimi”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet si vijon:

“6. Subjektet, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, do të pajisen me leje tregtimi të përkohshme, deri në plotësimin e kushteve për depozitat.”.

2. Në pikën 7 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pas fjalëve “subjektet që kryejnë aktualisht veprimtarinë“, shtohen fjalët “në tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”.

- Pas paragrafit të parë të shtohen dy paragrafe, me këtë përmbajtje:

“Bëjnë përjashtime nga ky afat, shoqëritë anonime të tregtimit me shumicë, që kanë marrëdhënie kontraktore, sipas dispozitave ligjore në fuqi për depozitat e karburanteve, në portin e Durrësit.

Kushti i kapacitetit minimal të depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse dhe i kalibrimit të tyre, duhet të plotësohet brenda 18 muajve pas fillimit të zbatimit të mastërplanit, në territorin e depozitave të karburanteve, në portin e Durrësit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta